

NJIHUNI ME PRISMAprepare Go ASISTENTI JUAJ VIRTUAL I PARAPRODUKSIONIT

Kërkesat e klientëve ndryshojnë. Një larmi e madhe punësh të ndryshme, në tirazhe më të ulëta printimi dhe për dorëzim me afate të ngushta.

Jeni prodhues i vogël printimesh, kështu që e kuptoni vetë thelbin. Ju shpenzoni gjithnjë e më shumë kohë për t'i bërë gati punët për shtyp, duke i kontrolluar manualisht skedarët e të dhënave. Duke regjistruar dhe kontrolluar porositë e reja – dhe punët e përsëritura. Kontroll paraprak. Që ju lë pak kohë për të fituar punë të reja, për të menaxhuar marrëdhëniet me klientët ekzistues dhe për të përdorur njohuritë dhe ekspertizën tuaj për të shtuar vlerë.

Ju e dini se ka një mënyrë më të mirë. Se dorëzimi i punëve dhe përgatitja e skedarëve përmes resë kompjuterike është rruga përpara. Problemi është se sakaq mendoni se automatizimi është kompleks dhe i kushtueshëm – në kohë dhe para – dhe se nuk është për ju. Jo akoma, gjithsesi.

Mendojeni dhe një herë.

Njihuni me PRISMAprepare Go – asistentin virtual të paraproduksionit që u mundëson prodhuesve të vegjël të printimeve një tranzicion të shpejtë dhe të lehtë drejt digjitalizimit. Pa kosto paraprake, pa qenë nevoja për një gjeni të informatikës për t'a vënë në punë dhe pa pasur nevojë për mirëmbajtje konstante.

Merrni. Përgatitni. Dorëzoni.

A ka më thjesht se kaq?



PRISMA



Canon

MOS PRITNI TË AUTOMATIZONI

PRISMAprepare Go është mënyra e thjeshtë, efikase, e sigurt dhe e përballueshme e përgatitjes dhe dorëzimit të punëve përmes resë kompjuterike për prodhuesit e vegjël të brendshëm dhe komercialë të printimeve.

Nga dorëzimi i punëve deri te procesimi dhe prodhimi, PRISMAprepare Go përmirëson ofertat tuaja me një shërbim tejet të strukturuar, profesional që konfigurohet dhe përdoret lehtë, si dhe me kosto efektive.

Hapni PRISMAprepare Go nga distanca në pajisje të ndryshme përmes PRISMA Home - qendra e besueshme dhe e sigurt për të gjitha zbatimet dhe funksionet me bazë reje kompjuterike nga PRISMA.

Dhe duke qenë se PRISMAprepare Go është SaaS (softuer si shërbim), ju duhet vetëm një trajnim minimal bazë përpara se ta vini në punë portalin tuaj të marrjes së punëve, nën markën tuaj, brenda pak orëve, jo ditëve dhe as javëve.

Me PRISMAprepare Go janë thjesht tre hapa të thjeshtë drejt një situatë fitimi të ndërsjellë, si për ju, ashtu edhe për klientët tuaj. Merrni, përgatitni, dorëzoni.

Mos pritni të automatizoni!

Për të mësuar më shumë për dorëzimet dhe ciklet e prodhimit të **PRISMAprepare Go** me bazë në renë kompjuterike, shkoni te www.canon-europe.com/prismapreparego



Merrni

PRISMAprepare Go ua bën të lehtë klientëve tuaj që të punojnë me ju. Në çdo kohë e vend, ata mund t'i dërgojnë punët duke tërhequr-lëshuar një apo më shumë skedarë PDF, duke shtuar komente apo dhe kërkesa të posaçme. Ose operatorët tuaj mund t'i dorëzojnë punët drejtpërdrejt për klientët. Me të hyrë në prodhuesin, raportet e ecurisë në kohë reale janë vetëm një klikim larg.

Nga ana juaj, punët hyjnë në ciklin e ri, të njësuar të paraproduksionit të PRISMAprepare Go - një mënyrë e thjeshtë dhe e rregullt për të marrë dhe përgatitur punë për prodhuesin. Kontrolli i integruar dhe i automatizuar paraparak raporton elementet e mundshme që mungojnë - si p.sh. madhësinë e faqes, fontet ose rezolucionin e imazhit.



Përgatitni

PRISMAprepare Go u mundëson operatorëve tuaj të ndërrojnë me lehtësi mes aplikacioneve, veglave dhe printerëve. Krijoni një larmi produktesh të ndryshme - dokumente me kapëse dhe/ose perforim, broshura me palosje, fletë me të njëjtën anë lart dhe me prerje-mbivendosje me shqyrtim në ngjyra të plota.

Përdorni pamjen paraprahe të PRISMAprepare Go 'Ajo që shikoni është ajo që merrni' Pamja e dokumentit dhe fletës për të minimizuar gabimet duke verifikuar në ekran rregullimet e formatimit të faqeve derisa bëhen.



Shko

PRISMAprepare Go është një pikë e vetme dorëzimi drejt presave tuaja të prodhimit të lidhura në rrjet. Mbështet shumicën e printerëve të prodhimit me pulte PRISMAsync, Fiery ose Canon DFE, si dhe pajisje gjenerike prodhimi që mbështetin JDF.

Përgatitni punë në bazë të pajisjeve të disponueshme të finicionit. Dërgojini punët drejtpërdrejt te PRISMAsync DocBoxes për riprintime të lehta dhe redaktime të çasteve të fundit. Për funksione të mëtejshme PRISMAsync Remote Manager mund dhe të ekzekutohet në terminale klient PRISMAprepare Go - dhe një shfletues i vetëm interneti është gjithçka ju duhet për të ndërruar mes PRISMAprepare Go dhe PRISMAsync Remote Manager.



PRISMA

Canon